

VENDIM
Nr. 689, datë 29.7.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1619, DATË 2.7.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE
TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të neneve 24, 32 e 54, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 13, të vendimit nr. 1619, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1 Struktura dhe kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2015 dhe fillojnë nga data e fillimit të marrëdhënieve financiare të administratorëve, sipas akteve të emërimit të tyre në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative

Lidhja nr.7

1.	Për njësitë administrative me 20.001 – 50.000 banorë - Administratori: 51.500 – 92.500 lekë
2.	Për njësitë administrative me 5.001 – 20.000 banorë - Administratori: 41.400 – 79.500 lekë
3.	Për njësitë administrative me më pak se 5.000 banorë - Administratori: 37.400 – 56.100 lekë